

Si reflektohet drita


Reflektimi i dritës

Pasqyrat e kthejnë mbrapsht (reflekojnë) dritën. Fleta e bardhë gjithashtu e reflekton dritën.

Pse shohim pamje të qartë në pasqyrë dhe jo në fletën e bardhë?

Fleta e letrës ka sipërfaqe të vrazhdë. Kur rrezet e dritës bien në fletë ato shpërndahen në të gjitha drejtimet.

Pasqyra ka sipërfaqe të rrafshët të lëmuar. Rrezet e dritës reflektohen nga pasqyra pa shpërndarje.



Ligji për reflektim

Rrezja e dritës reflektohet nga pasqyra.

Ligji për reflektim (pasqyrim) na tregon se në cilin kënd do të kthehet mbrapsht rrezja.

Vizatimi duhet të kuptohet në këtë mënyrë:

Vija vertikale paraqet pasqyrën;

Pjesa e vijëzuar është ana e pasme e pasqyrës.

Rrezja që bie mbi pasqyrë është rrezja rënëse. Rrezja që del është rrezja e reflektuar.

Për ta përcaktuar drejtimin e rrezes së reflektuar, duhet të tërheqim normalen në sipërfaqen e pasqyrës.


Normalja është vijë e drejtë e vendosur nën këndin e drejtë, në raport me pasqyrën në pikën e rënies

Ligji për reflektimin e dritës thotë se këndi i reflektimit është i njëjtë me këndin e rënies.

(Vëreni se këndi matet ndërmjet rrezes dhe normales).

Ligji për reflektimin e dritës:

këndi i reflektimit = këndin rënës



Detyrë shtëpie
Faqe 67
Pyetja 1,2,3